



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 252, Datë 06.10.2022

MBI

KËRKESËN E SHOQËRISË “C&S CONSTRUCTION ENERGY” SH.P.K. PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 188, DATË 21.07.2022 “MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “C&S CONSTRUCTION ENERGY” SH.P.K. PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË ERE-S NR. 67, DATË 27.10.2011 “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DOSKU - ENERGY” SH.P.K. NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE” DHE HEQJEN E LICENCËS SË SHOQËRISË “DOSKU ENERGY” SH.P.K. PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16 pika 5, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 3, pika 7, gërma “a”, nenit 33, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” si dhe nenit 5, pika 23, nenit 15 dhe nenit 16 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.10.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, Këshilltari i Bordit dhe Sekretari i Përgjithshëm me nr. 1746-1 prot., datë 05.10.2022, “Mbi kërkesën e shoqërisë “C&S Construction Energy” sh.p.k. për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 188, datë 21.07.2022”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 188, datë 21.07.2022 ka vendosur ndër të tjera:
 1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k., për shfuqizimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 67, datë 27.10.2011, i ndryshuar.
 2. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “DOSKU-ENERGY” sh.p.k. për shkelje të kushtit të vendosur në pikën 2.2 të kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike.
- ERE ka njoftuar shoqërinë “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k. dhe palët e interesit për vendimin nr. 188/2022 nëpërmjet shkresës nr. 207/21, datë 01.08.2022.

- Me shkresën e datës 02.09.2022, protokolluar në ERE me nr. 1507/4 prot., datë 06.09.2022, shoqëria “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për rishikimin e këtij vendimi dhe shfuqizimin e vendimit nr. 67, datë 27.10.2011 “Për licencimin e shoqërisë “DOSKU ENERGY” sh.p.k., si akt i paligjshëm që vjen në kundërshtim me ligjin.
- Shoqëria “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k. konsiderohet palë në këtë proces për sa përcaktuar në nenin 3, pika 7, gërma “a” dhe nenin 33, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenin 16, pika 5 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenin 5, pika 23 dhe nenin 16, pika 1 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96/2016.
- Përsa i përket afatit për paraqitjen e kërkesës për rishikim, që përbën dhe kushtin e dytë për të paraqitur një kërkesë të tillë, vetë shoqëria “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k. ka marrë dijeni për vendimin e bordit të ERE-s nr. 188/2022 nëpërmjet shkresës 207/24 prot., datë 25.08.2022, për të cilën ka marrë dijeni efektivisht nëpërmjet rrugës postare në datën 29.08.2022.
- Për sa i përket parashtrimeve dhe pretendimeve se: *shoqëria “DOSKU-ENERGY” sh.p.k. nuk ka përmbushur kushtet thelbësore të licencimit të dhënë sipas ligjit e një ndër kushtet është mungesa e kontratës së koncesionit*, sqarojmë se: ky pretendim është ngritur dhe më parë dhe është bërë pjesë e shqyrtimit të rrethanave dhe fakteve mbi të cilat është marrë dhe vendimi i bordit të ERE-s nr. 188, datë 21.07.2022. Konkretisht, sa i përket kontratës së koncesionit, ERE ka shqyrtuar këtë pretendim dhe janë bërë konstatimet përkatëse në faqen 3 të vendimit të bordit nr. 188/2022 dhe në këto rrethana kjo nuk përbën provë të re, të tillë që ta çojë bordin e ERE-s të marrë një vendim të ndryshëm.
- Sa pretenduar në lidhje me lejen e ndërtimit, dokumentacionin pronësor etj., është shqyrtuar gjithashtu gjatë marrjes së vendimit të bordit të ERE-s nr. 188/2022 dhe janë bërë konstatimet përkatëse në faqen 3 dhe 4 të këtij vendimi. Po ashtu, shkresa e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) nr. 1167/4 prot., datë 24.09.2020 drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), për dijeni shoqërisë “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k. është marrë gjithashtu në shqyrtim (faqja 3 e vendimit nr. 188/2022). Po ashtu gjatë mbledhjes së bordit të ERE-s të datës 21.07.2022, nga ana e shoqërisë “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k. është bërë me dije vendimi i nxjerrë nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) për marrjen e masës administrative pezullim të aktivitetit të shoqërisë “Dosku Energy” sh.p.k. Në vijim, nga ana e shoqërisë është depozituar Vendimi përfundimtar i inspektimit i IKMT-DQ-2022-000112-5, datë 14.07.2022, nga ku rezulton se bazuar në inspektimin e kryer në subjektin “DOSKU-ENERGY” sh.p.k., janë konstatuar shkelje të kërkesave ligjore në mbështetje të ligjit nr. 112/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 41,

pika 1, gërma “c” dhe neni 97, pika 3, të cilat klasifikohen si kundravajtje administrative dhe për këtë parashikohen dënimet gjobë dhe pezullim i aktivitetit.

Me shkresën nr. 207/22 prot., datë 01.08.2022, ERE ka njoftuar për këtë vendimmarrje Operatorin e Sistemit të Shërndarjes (OSSH) sh.a., Furnizuesin e Tregut të Lirë (FTL) sh.a., shoqërinë “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k., shoqërinë “Dosku Energy” sh.p.k. dhe Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU).

Në vijim të sa më sipër, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1507 prot., datë 29.08.2022 dhe nr. 1507/1 prot., datë 01.09.2022, shoqëria “DOSKU-ENERGY” sh.p.k. ka depozituar në ERE Vendimin nr. 82-2022-652, datë 22.08.2022, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, ku është vendosur pranimi i kërkesë së shoqërisë “DOSKU-ENERGY” sh.p.k. për sigurimin e padisë dhe pezullimin e zbatimit të pikës 2 të Vendimit përfundimtar të inspektimit nr. IKMT-DQ-2022-000112-5, datë 14.07.2022, të IKMT Drejtoria Qendrore, nëpërmjet së cilës është disponuar dënimi administrativ plotësues “Pezullim i aktivitetit”, deri në përfundimin e gjykimit të çështjes administrative me vendim të formës së prerë.

ERE nuk mund të shprehet për këtë çështje sa kohë ajo është në shqyrtim nga një organ gjyqësor. Në çdo rrethanë, duhet theksuar se edhe pasi ograni gjyqësor të shprehet me vendim të formës së prerë, që ERE të shprehet në vijim, duhet që ky vendim të afektojë vendimmarrjen e ERE-s në funksion të ushtrimeve të kompetencave të saj dhe vetëm brenda këtyre kompetencave që i njeh ligji material dhe aktet nënligjore në fuqi.

Për gjithë sa më sipër nuk rezulton që nga ana e shoqërisë “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k. të jetë depozituar ndonjë provë e re, e tillë që të çojë bordin e ERE-s të ndryshojë vendimin nr. 188/2022.

- Përsa i përket pretendimit në lidhje me lejen për përdorimin e burimit ujor, ai është shqyrtuar gjithashtu në marrjen e vendimit të bordit nr. 188/2022 (faqja 4). Përveç sa shqyrtuar, sikurse cituar dhe më sipër, shkelja e dispozitave të ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar, është një çështje e cila po shqyrtohet nga organi kompetent gjyqësor. Nuk rezulton që nga ana e shoqërisë “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k. të jetë depozituar ndonjë provë e re, e tillë që të çojë bordin e ERE-s të ndryshojë vendimin nr. 188/2022.
- Për sa pretenduar nga shoqëria në lidhje me rrezikimin e jetës, shëndetit dhe pasurisë së qytetarëve, e cila përbën dhe një nga kushtet për të filluar procedurën për heqjen e një licence, sqarojmë se është marrë në shqyrtim në vendimin nr. 188/2022 (faqja 5 dhe 6), ku është konstatuar se nuk rezulton që të jetë provuar e dokumentuar se si rezultat i ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga shoqëria “DOSKU ENERGY” sh.p.k. të jetë rrezikuar jeta apo pasuria e personave të kësaj shoqërie, dokumenti i cili duhet të mbajë vulën e organeve përkatëse që kanë dhe kompetencën për të përcaktuar ardhjen e një pasoje të tillë. Nga ana tjetër për sa i përket pretendimit të shoqërisë në lidhje me vendosjen e kabllit të tensionit të lartë, duke qenë se verifikimi i kushteve apo sigurisë së vendosjes së tij nuk është kompetencë e ERE-s, kjo e fundit ka

njoftuar për këtë fakt shoqërinë “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k. me shkresën nr. 1507/5 prot., datë 09.09.2022. Po ashtu, me shkresën nr. 1507/6 prot., datë 12.09.2022, ka vënë në dijeni për sa pretenduar nga shoqëria Operatorin e Sistemit të Shpërndartjes (OSSH sh.a.), Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) dhe shoqërinë “DOSKU-ENERGY” sh.p.k.

Për sa më sipër nuk rezulton që nga shoqëria “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k. të jetë depozituar ndonjë provë e re, e tillë që të çojë bordin e ERE-s të ndryshojë vendimin nr. 188/2022.

- Shoqëria “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k. pretendon se përsa i përket shkeljes së dispozitave për mbrojtjen e mjedisit, shoqëria ka sjellë sërish në vëmendje Vendimin e IKMT me nr. IKMT-DQ-2022-000112-5, datë 14.07.2022, nëpërmjet të cilit janë marrë masa pasi janë konstatuar shkelje të dispozitave për mbrojtjen e mjedisit. Sqarojmë se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, ka vendosur pezullimin e zbatimit të pikës 2 të këtij vendimi deri në përfundimin e gjykimit të çështjes administrative me vendim të formës së prerë. Në këto rrethana nuk rezulton që nga ana e shoqërisë “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k. të jetë depozituar ndonjë provë e re, e tillë që të çojë bordin e ERE-s të ndryshojë vendimin nr. 188/2022.
- Në përfundim shoqëria ka kërkuar rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s, në mënyrë që të merren parasysh të gjitha pretendimet e saj, pasi nuk ka vetëm shkelje të kushteve të pikës 2.2 të licencës, për sa i përket rritjes së kapacitetit, por edhe shkelje të dispozitave për mbrojtjen e mjedisit, kryerja e punimeve që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe më kryesorja mungesa e kontratës së koncesionit si një nga kushtet thelbësore për dhënien e licencës. Në këto kushte dhe për sa parashtruar, shoqëria “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k. ka kërkuar nga ERE që të procedojë me shfuqizimin e vendimit të ERE-s nr. 67, datë 27.07.2011, dhe heqjen e licencës së shoqërisë “DOSKU-ENERGY” sh.p.k. me nr. 134, seria PV11P.
- Për gjitha sa më sipër pretenduar nga ana e shoqërisë, kusht që bordi i ERE-s të rishikojë një vendim të tij është paraqitja e provave të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara. Nuk rezulton që nga ana e shoqërisë “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k. të jetë depozituar ndonjë provë e re, e tillë që të çojë bordin e ERE-s në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga vendimi nr. 188/2022, ndaj vlerësohet që kërkesa e saj për rishikimin e këtij vendimi duhet të rrëzohet.
- Nga ana e pëfaqësuesve të shoqërisë “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k., të pranishëm në mbledhje, u bë me dije se disponon një tabelë fotografike, të vënë në dispozicion nga Prokuroria Elbasan, ku është realizuar këqyrja e ambjenteve të HEC Gizavesh, të datës 12.05.2022, por që shoqëria vetë nuk e ka disponuar më parë këtë dokument. Gjithsesi, duke mos qenë akt/vendim përfundimtar i organeve apo

institucioneve, nuk përbën provë të re të tillë që të ndryshojë vendimin e Bordit të ERE-s 188/2022.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rrëzojë kërkesën e shoqërisë “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k. për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 188, datë 21.07.2022 “Mbi kërkesën e shoqërisë “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k. për shfuqizimin e vendimit të ERE-s nr. 67, datë 27.10.2011 “Për licencimin e shoqërisë “DOSKU - ENERGY” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike” dhe heqjen e licencës së shoqërisë “DOSKU ENERGY” sh.p.k. për prodhimin e energjisë elektrike”.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “C&S CONSTRUCTION ENERGY sh.p.k për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

Votimi i Bordit të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 252, Datë 06.10.2022

MBI

KËRKESËN E SHOQËRISË “C&S CONSTRUCTION ENERGY” SH.P.K. PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 188, DATË 21.07.2022 “MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “C&S CONSTRUCTION ENERGY” SH.P.K. PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË ERE-S NR. 67, DATË 27.10.2011 “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DOSKU - ENERGY” SH.P.K. NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE” DHE HEQJEN E LICENCËS SË SHOQËRISË “DOSKU ENERGY” SH.P.K. PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Anëtarët e Bordit

Pro

Kundër

Petrit Ahmeti

Erjola Sadushi

Maksim Shuli

Raimonda Islamaj

Petraç Lika
